



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 7

Tiranë – E hënë, 21 shkurt 2022

PËRMBAJTJA

Faqe

Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 2855, datë 15.2.2022	Për shitje me ankand të pronës shtetërore, në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara; të Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë, Tiranë, si dhe të shoqërisë “Kamberi Administrim” sh.p.k.....	3
Kërkesë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 80/2, datë 17.2.2022	Për marrjen me qira të ambienteve për nevoja të sistemimit të punonjësve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.....	5
Kërkesë e Ministrisë së Drejtësisë nr. 441, datë 17.2.2022	Për publikimin e thirrjes për financimin e OJF-ve të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore.....	7



NJOFTIM
Nr. 2855, datë 15.2.2022

**PËR SHITJE ME ANKAND TË
 PRONËS SHTETËRORE NË
 ADMINISTRIM TË AGJENCISË SË
 ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË
 SEKUESTRUARA DHE TË
 KONFISKUARA**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 888, datë 11.11.2020, “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”, shpallen për shitje me çmim fillestar, si më poshtë:

1. Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lek)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Mjetet kryesore	Arë			Data	Ora	Vendi
1.	Tokë arë	Yzberisht, Tiranë	965 250	0	965 250	1 485	0	16.3.2022	09:30	DDPP

2. Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lek)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Mjetet kryesore	Njësi			Data	Ora	Vendi
1.	Bodrum me nr. 5/56-B2	Shëngjin, Lezhë	643 312	0	643 312	11.6		16.3.2022	10:00	DDPP

3. Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lek)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Mjetet kryesore	Njësi			Data	Ora	Vendi
1.	Bodrum me nr. 5/56-B3	Shëngjin, Lezhë	643 312	0	643 312	11.6		16.3.2022	10:30	DDPP



Çdo person fizik apo juridik, i interesuar për blerje me ankand, duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lek, për llogari të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

3. Deklarimin personal të secilit pjesëmarrës, që vërteton se ky i fundit nuk është në konflikt interesi, sipas dispozitave të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 34/2019, të ndryshuar.

4. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrues brenda afatit të pranimit të

kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pasi të keni tërhequr pranë kësaj agjencie faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: www.financa.gov.al.

NJOFTIM

Nr. 2855, datë 15.2.2022

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË INSTITUTIT TË PËRGATITJES SË QENVE TË POLICISË, TIRANË

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, shpall për shitje me VAM të ulur, si më poshtë:

1. Në administrim të Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë, Tiranë

Nr.	Emërtimi	Datëlindja	Vendndodhja	Vlera fillestare e ankandit në lek	Zhvillimi i ankandit		
					Data	Ora	Vendi
1	Qeni Lisa	5.3.2020	Tiranë	10 000	16.3.2022	10:45	DDPP
2	Qeni Laza	5.3.2020	Tiranë	10 000	16.3.2022	11:00	DDPP
3	Qeni Deja	5.3.2020	Tiranë	10 000	16.3.2022	11:15	DDPP
4	Qeni Deni	8.4.2020	Tiranë	10 000	16.3.2022	11:30	DDPP
5	Qeni Maxhi	8.4.2020	Tiranë	10 000	16.3.2022	11:45	DDPP
6	Qeni Xhena	18.7.2020	Tiranë	10 000	16.3.2022	12:00	DDPP
7	Qeni Zita	25.7.2020	Tiranë	10 000	16.3.2022	12:15	DDPP
8	Qeni Jona	19.1.2013	Tiranë	4 000	16.3.2022	12:30	DDPP
9	Qeni Orsa	19.1.2013	Tiranë	4 000	16.3.2022	12:45	DDPP
10	Qeni Dea	3.9.2013	Tiranë	4 000	16.3.2022	13:00	DDPP
11	Qeni Lukas	3.9.2013	Tiranë	4 000	16.3.2022	13:15	DDPP
12	Qeni Diksi	11.5.2011	Tiranë	4 000	16.3.2022	13:30	DDPP
13	Qeni Dei	3.10.2013	Tiranë	4 000	16.3.2022	13:45	DDPP
14	Qeni Riku	3.10.2013	Tiranë	4 000	16.3.2022	14:00	DDPP
15	Qeni Konti	15.9.2012	Tiranë	4 000	16.3.2022	14:15	DDPP
16	Qeni Grei	14.10.2020	Tiranë	10 000	16.3.2022	14:30	DDPP

Çdo person fizik apo juridik, i interesuar për blerje, duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerje e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Garancinë bankare apo mandatpagesën në origjinal, që vërteton ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lek, për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).



Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën shpallur për shitje, i konfiskohet 20% e garancisë bankare, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Garancia bankare apo mandatpagesa duhet të bëhet detyruesisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Garancia bankare apo mandatpagesa mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë: www.financa.gov.al.

1. Në pronësi të Shoqërisë “Kamberi administrim” sh.p.k.

Nr.	Emërtimi	Vendndodhja	Vlera fillestare e ankandit në lekë	Zhvillimi i ankandit		
				Data	Ora	Vendi
1	Motogjenerator, marka TROGENO-TORINO, e tipit MV nr. 118	Rruga “Pirro Godo”, Tiranë	110 000	16.3.2022	09:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand, duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lek, për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyruesisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë

NJOFTIM
Nr. 2855, datë 15.2.2022

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE, NË ADMINISTRIM TË SHOQËRISË “KAMBERI ADMINISTRIM” SHPK

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, kapitulli III, shpall për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: www.financa.gov.al.

KËRKESË
Nr. 80/2, datë 17.2.2022

PËR MARRJEN ME QIRA TË AMBIENTEVE PËR NEVOJA TË SISTEMIMIT TË PUNONJËSVE TË KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

I. Kriteret ligjore që duhet të plotësojnë ofertuesit

1. Kërkesë e ofertuesit për pjesëmarrje në konkurrim.

2. Të jenë titullarë të ligjshëm të pronës të vërtetuar me certifikate pronësie, lëshuar nga ASHK-ja, shoqëruar me kartelën e pasurisë, hartën treguese të pronës dhe gentplanin.



3. Vërtetim hipotekar, që prona nuk është në sekuestro dhe është e lirë nga çdo barrë hipotekare apo detyrim tjetër ligjor, lëshuar nga ASHK-ja.

4. Vërtetim nga FSHU-ja, që nuk ka detyrime të pashlyera dhe kopje të kontratës së furnizimit të energjisë elektrike.

5. Vërtetim nga UKT-ja, që nuk ka detyrime të pashlyera dhe kopje të kontratës së furnizimit nga ujësjellës-kanalizimet.

6. Vërtetim që ofertuesi nuk është në ndjekje penale apo në proces gjyqësor.

7. Nëse është tregtar/shoqëri tregtare duhet të paraqesë edhe:

a) NIPT/NUIS, certifikatë të regjistrimit dhe ekstrat historik i regjistrimit të subjektit, që vërteton se ka status aktiv;

b) vërtetim nga tatim-taksat që nuk ka detyrime të pashlyera;

c) vërtetim që nuk ka sigurime shoqërore të pashlyera nga *e-Sigurime*;

d) vërtetim nga institucionet përkatëse, që subjekti apo përfaqësuesi ligjor i tij nuk është në

ndjekje penale, si dhe nuk është në proces gjyqësor në lidhje me aktivitetin;

e) në ofertën e tij subjekti i interesuar, duhet të japë të dhëna të sakta të personit të kontaktit.

8. Vetëdeklarim që ofertuesi nuk është në konflikt interesi me Kolegjin e Posaçëm të Apelit.

9. Vetëdeklarim për plotësimin e të gjitha kriterëve ligjore dhe kërkesave specifike të ambienteve që kërkohen nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.

10. Kopje ID e titullarit të pronës/ambienteve.

11. Vërtetim të numrit të llogarisë bankare në një nga bankat e nivelit të dytë në RSH-së.

12. Ofertë me shkrim e çmimit të qirasë së ambienteve në muaj (veç kërkesave të tjera, oferta të jetë e nënshkruar nga administratori ose pronari i ambientit dhe të përmbajë të dhënat, sipas tabelës më poshtë).

Nr.	Emri dhe NIPT-i i subjektit	Përshkrimi	Sasi	Sip. totale në m ²	Çmimi pa TVSH (në lek)	Çmimi me TVSH (në lek)
1		Ambient me qira				

13. Oferta fituese do të jetë oferta me çmimin më të ulët (oferta ekonomisht më e favorshme), e cila plotëson të gjitha kriteret ligjore dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin për marrjen e ambienteve me qira për zyra, për punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

14. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Kërkesat specifike të ambienteve objekt qiramarrjeje

1. Ambient për zyra me sipërfaqe totale 120 m²–150 m², ku duhet të përfshijë të paktën 3 ambiente për zyra dhe 1 tualet (të kompletuar me pajisjet hidrosanitare dhe pajisjet për ujë të ngrohtë).

2. Ambientet duhet të kenë të instaluar sistem vëzhgimi me kamera në hyrje të tyre.

3. Ambientet duhet të kenë furnizim me ujë dhe energji elektrike 24/7 dhe të jenë të pajisura

me matës të dedikuar të ujit dhe të energjisë elektrike.

4. Ambientet duhet të kenë sistem kondicionimi, të instaluar dhe plotësisht funksional.

5. Ambientet duhet të kenë rrjet interneti të instaluar, si dhe rrjetin e prizave të energjisë elektrike, për çdo post pune.

6. Ambientet duhet të jenë të përfunduara me dyer, dritare, të lyera dhe të gatshme/të lira për t'u shfrytëzuar nga qiramarrësi. Dera kryesore hyrëse në këto ambiente duhet të jetë me konstruksion metalik.

7. Ambientet duhet të jenë sa më pranë selisë së Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe jo më shumë se 400 metra në vijë ajrore larg godinës së Kuvendit të Shqipërisë, me adresë bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.

8. Ambientet duhet të jenë boshe dhe të lira, dorëzimi i objektit do të bëhet brenda 5 (pesë) ditëve pune nga njoftimi për lidhje kontrate.

9. Ofertuesi duhet të përcaktojë çmimin (oferta ekonomike), vlerën mujore të qirasë për



një muaj, duke përfshirë të gjitha detyrimet tatimore sipas legjislacionit në fuqi.

10. Pagesa e qirasë do të bëhet çdo muaj në llogarinë, në lek, të qiradhënësit, brenda datës që palët do të bien dakord në kontratën me shkrim, kundrejt lëshimit të faturës tatimore elektronike për subjektet tregtare. Në rast se qiradhënësi është individ dhe nuk mund të lëshojë faturë tatimore, pagesa e detyrimeve do të kryhet nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për taksat dhe tatimet dhe shuma e detyrimeve do t'i zbritet qiradhënësit nga vlera e qirasë.

11. Afati i kontratës së qiradhënies të jetë jo më pak se një vit me të drejtë rinovimi. Afati do të përcaktohet gjithmonë nga qiramarrësi, i cili njofton me shkrim 30 ditë para mbarimit të kontratës qiradhënësin.

12. Detyrimet që lindin nga përdorimi i energjisë elektrike, ujit dhe internetit gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës së qirasë do të përmbushen nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit.

III. Paraqitja e dokumenteve dhe e ofertës së qirasë së ambienteve

1. Dorëzimi i dokumenteve dhe i ofertës ekonomike duhet të bëhet brenda datës 7 mars 2022, ora 16:30, me postë ose dorazi, pranë institucionit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën: bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.

2. Për çdo komunikim apo sqarim, ofertuesit mund të shkruajnë në adresën elektronike: info@kpa.al.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Laerta Rooze

KËRKESË

Nr. 441, datë 17.2.2022

PËR PUBLIKIMIN E THIRRJES PËR FINANCIMIN E OJF-ve TË AUTORIZUARA PËR OFRIMIN E NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

HAPEN PROCEDURAT E APLIKIMIT
PËR PËRFITIMIN E FINANCIMEVE NGA
BUXHETI I SHTETIT TË ORGANIZATAVE
JOFITIMPRURËSE TË AUTORIZUARA NGA
MINISTRI I DREJTËSISË, PËR OFRIMIN E
NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE TË
GARANTUAR NGA SHTETI

**- Udhëzues mbi thirrjen për financimin e
organizatave jofitimprurëse të autorizuar nga
ministri i Drejtësisë**

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në bazë të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe VKM-së nr. 110, datë 6.3.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”, si dhe të urdhrit nr. 5, datë 18.1.2022, të drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, “Për miratimin e metodologjisë mbi procedurat e financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuar”, bën publik njoftimin si më poshtë:

Bazuar në nenin 15, pika 3, të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, organizatat jofitimprurëse të autorizuar për dhënie e ndihmës juridike parësore përfitojnë financime nga buxheti i shtetit, pas një procesi konkurrues dhe transparent përzgjedhjeje. Procedura, rregullat e përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse të autorizuar, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre përcaktohen në VKM-në nr. 110, datë 6.3.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”.

Të gjitha organizatat jofitimprurëse të autorizuar për t'u kualifikuar për të përfituar



financime, duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në pikën 6, të VKM-së nr. 110, datë 6.3.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”,

si më poshtë vijon:

a) Kriteret të përgjithshme:

i. të kenë marrë autorizimin nga ministri i Drejtësisë për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti;

ii. të mos kenë dy burime të njëjta financimi për të njëjtin aktivitet (deklaratë e organizatës se nuk përfiton burime të tjera financimi për të njëjtin aktivitet);

iii. të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi që cenon zhvillimin e drejtë të procesit të përzgjedhjes me drejtorin e Ndihmës Juridike Falas (përcjellja e deklaratës së organizatës jofitimprurëse).

b) Kriteret të veçanta:

i. projektpropozimin, i cili përmban të dhënat teknike-financiare për ofrimin e shërbimit, qëllimin, objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara, përfituesit e drejtpërdrejtë;

ii. të dhëna për personelin, duke specifikuar detyrat dhe siguruar jetëshkrimin e tyre;

iii. të dëshmojnë se kanë përvojë në realizimin e shërbimeve të ngjashme, duke siguruar dokumente dhe të dhëna të realizimit të shërbimeve të ngjashme në të kaluarën.

Organizata jofitimprurëse e autorizuar duhet të dëshmojë se i plotëson kriteret e veçanta, duke

dorëzuar dokumentet përkatëse sipas thirrjes publike.

Në rast të mosplotësimit të një prej kriterëve të veçanta, aplikimi konsiderohet i paplotë dhe, si i tillë, nuk kualifikohet për përfitimin financiar.

Dokumentet duhet të jenë të noterizuara dhe duhet të dorëzohen me postë në zyrat e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, **brenda 30 ditëve kalendarike nga momenti i publikimit të thirrjes në Fletoren Zyrtare, 21 shkurt 2022–22 mars 2022**, fizikisht, në adresën: **rruga “Jordan Misja”, Njësia Bashkiake nr. 9, godina nr. 3 Tiranë**, sipas anekseve, si vijon:

1. Udhëzues mbi thirrjen për financimin e organizatave jofitimprurëse të autorizuar;

2. Aneksi 1: Lista e dokumenteve të nevojshme për aplikim;

3. Aneksi 2: Formulari tip i aplikimit;

4. Aneksi 3: Plani financiar i aktiviteteve/i logistikës dhe i pagesave;

5. Deklaratë tip mbi financimin e dyfishtë;

6. Formulari tip i deklarimit të konfliktit të interesit;

7. Metodologjia mbi procedurat e financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuar.

Dokumentacioni i kërkuar, sipas anekseve nr. 1, 2 dhe 3, është i specifikuar në urdhrin nr. 5, datë 18.1.2022, të drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, “Për miratimin e metodologjisë mbi procedurat e financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuar”, bashkëlidhur kësaj thirrjeje.



ANEKS 1

LISTA E DOKUMENTEVE TË NEVOJSHËM PËR APLIKIM

Përbën shkak automatik skualifikimi, mungesa e dokumentacionit, sipas kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta, përveç dokumentacionit, që përbën avantazh (cituar).

Kritere të përgjithshme mbi organizimin dhe funksionimin e OJF-ve të autorizuar
1. Statuti i organizatës jofitimprurëse të autorizuar (i përditësuar), ku objekti i veprimtarisë së organizatës të jetë dhe ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike; 2. Akti i themelimit të organizatës jofitimprurëse të autorizuar (i përditësuar); 3. Aktet e emërimit të organeve vendimmarrëse, duke përfshirë edhe aktin për caktimin e përfaqësuesit ligjor të organizatës jofitimprurëse (i përditësuar); 4. Dokumenti i regjistrimit në organin tatimor (NIPT), ku objekti i veprimtarisë së organizatës të jetë dhe ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike; 5. Numri unik i identifikimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹; 6. Akti i autorizimit nga ministri i Drejtësisë, për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti.
Kritere të veçanta – Kapacitetet e burimeve njerëzore/personelit
1. ID-ja e anëtarëve të organeve vendimmarrëse dhe e përfaqësuesit ligjor të organizatës; 2. ID-ja e punonjësve të organizatës; 3. CV-ja e anëtarëve të organeve vendimmarrëse dhe e përfaqësuesit ligjor të organizatës; 4. CV-ja e punonjësve të organizatës (avokatë, jurist, financier dhe çdo punonjës tjetër, që ka rol në plotësimin e objektivave të projektit); 5. Përshkrimet e punës dhe kontratat e punës së punonjësve të organizatës (avokatë, jurist, financier dhe çdo punonjës tjetër, që ka rol në plotësimin e objektivave të projektit); 6. Certifikatat e trajnimeve të punonjësve të lartpërmendur, në funksion të zbatimit të objektivave të projektit (nëse ka, përbën avantazh në procesin e pikëzimit²); 7. Vërtetim nga prokuroria dhe gjykata se anëtarët e organeve vendimmarrëse dhe të përfaqësuesit ligjor të organizatës nuk janë në proces hetimi apo gjykimi, për çështje që cenojnë besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike; 8. Vërtetim nga prokuroria dhe gjykata për punonjësit e organizatës, që nuk janë në proces hetimi apo gjykimi për çështje që cenojnë besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike; 9. Deklaratë për mosekzistencën e ndonjë konflikti interesi, që cenon zhvillimin e drejtë të procesit të përzgjedhjes me titullarin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas nga anëtarët e organeve vendimmarrëse dhe përfaqësuesit ligjorë të organizatës; 10. Deklaratë për mosekzistencën e ndonjë konflikti interesi, që cenon zhvillimin e drejtë të procesit të përzgjedhjes me titullarin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas nga punonjësit e organizatës.
Kritere të veçanta – Aktivitet afatgjatë të organizatës
1. Certifikatë pronësie e ambientit ku ushtrohet aktiviteti ose kontratë qiraje; 2. Kopje të inventarëve fizikë të pajisjeve (kompjuter; printer; tavolina; karrige etj.), që disponon organizata në funksion të ushtrimit të aktivitetit të punonjësve ose çdo dokument tjetër, që vërteton gjendjen e aseteve në funksion të veprimtarisë së OJF-së; 3. Dokument (foto), që vërteton faktin se vendndodhja e organizatës është lehtësisht e aksesueshme nga qytetarët dhe mjediset ku do të ofrohet shërbimi të ofrojnë mundësinë e aksesimit nga personat me aftësi të kufizuara (përbën avantazh)³. 4. Dokument (foto), që vërteton faktin se organizata mundëson një ambient të veçantë për trajnimin e rasteve të shërbimit të ndihmës juridike parësore me një karakter sensitiv (përbën avantazh)⁴.
Kritere të veçanta – Kapaciteti financiar i organizatës
1. Kopje të kontratave të grantit me partnerë, në kuadër të zbatimit të projekteve të ngjashme të tre vjetëve të fundit; 2. Kopje të raportimeve përfundimtare narrative dhe financiare të realizimit të granteve me partnerë, në kuadër të zbatimit të projekteve të ngjashme të tre vjetëve të fundit; 3. Vërtetimi nga partnerët për realizimin e suksesshëm të kontratave të grantit (përbën avantazh)⁵;

¹ Referuar përcaktimeve të ligjit nr. 80/2021, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”. Mungesa e numrit unik nuk është shkak për skualifikim, duke marrë në konsideratë kohën e shkurtër që nga implementimi i ligjit dhe vonesat në zbatimin e tij.

² Nuk përbëjnë shkak për skualifikim, por ndikojnë në procesin e vlerësimit të projekteve. Mospërcjellja e dokumentacionit që përbën avantazh, vlerësohet me 0 pikë në tabelën e vlerësimit.

³ Nuk përbëjnë shkak për skualifikim, por ndikojnë në procesin e vlerësimit të projekteve. Mospërcjellja e dokumentacionit, që përbën avantazh, vlerësohet me 0 pikë në tabelën e vlerësimit.

⁴ Nuk përbëjnë shkak për skualifikim, por ndikojnë në procesin e vlerësimit të projekteve. Mospërcjellja e dokumentacionit, që përbën avantazh, vlerësohet me 0 pikë në tabelën e vlerësimit.



4. Vërtetim nga organet tatimore që organizata nuk ka detyrime tatimore të papaguara (i përditësuar);
5. Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për deklarimin e pagesave të kontributeve për sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat për të gjithë punonjësit (i përditësuar);
6. Listëpagesa e punonjësve, sipas legjislacionit në fuqi (borderoja e pagave e 3 (tre) muajve të fundit) shoqëruar me dokumentin që vërteton pagesën;
7. Vërtetim i llogarisë bankare të organizatës;
8. Pasqyrat financiare të vitit të fundit të nënshkruara nga hartuesi i pasqyrave financiare dhe të nënshkruara nga drejtuesi i organizatës, të konfirmuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
9. Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve që organizata nuk është në proces falimentimi;
10. Raport vlerësues përfundimtar i kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe financiare të OJF-së i ushtruar nga shoqëri të licencuara auditimi (përbën avantazh⁵);
11. Deklaratë e organizatës që nuk përfiton burime të tjera financimi për të njëjtin aktivitet, për të cilin është duke aplikuar pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas;
12. Oferta financiare e projektit sipas thirrjes.

Kritere të veçanta – Performanca e organizatës që nga momenti i autorizimit për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga ministri i Drejtësisë

1. Deklaratë mbi numrin total të rasteve të ndihmës juridike parësore, të garantuar nga shteti, të raportuara pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, që nga momenti i autorizimit nga ministri i Drejtësisë (përbën avantazh⁷);
2. Letra vlerësimi nga të paktën 2 (dy) subjekte përfituese nga shërbimet e ndihmës juridike parësore (përbën avantazh⁸).

ANEKS 2
FORMULAR TIP I APLIKIMIT

PJESA I
INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Titulli i projektit	
Emri i organizatës jofitimprurëse	
Statusi ligjor (së bashku me ndryshimet që kanë pësuar aktet themelore të organizatës, duke bashkëngjitur vendimet përkatëse të gjykatës nr.)	<i>Numri i vendimit dhe data e regjistrimit në gjykatë</i> <i>NIPT-i</i> <i>Emri i Bankës</i> <i>Numri IBAN</i> <i>Nr. i llogarisë Bankare (në lek)</i>
Autorizim i ministrit të Drejtësisë	<i>Nr. dhe data e autorizimit nga ministri i Drejtësisë</i>
Adresa:	
E-mail:	
Website:	
Vendi/et ku zbatohet projekti	
Personi i kontaktit	
Pozita në organizatë	
Fondet e kërkuara nga DNJF-ja	
Përshkrim i projekteve të ngjashme të tri viteve të fundit në rend zbritës	
Nënshkrimi i drejtuesit/përfaqësuesit të organizatës	

⁵ Nuk përbëjnë shkak për skualifikim, por ndikojnë në procesin e vlerësimit të projekteve. Mospërcjellja e dokumentacionit, që përbën avantazh, vlerësohet me 0 pikë në tabelën e vlerësimit.

⁶ Nuk përbëjnë shkak për skualifikim, por ndikojnë në procesin e vlerësimit të projekteve. Mospërcjellja e dokumentacionit, që përbën avantazh, vlerësohet me 0 pikë në tabelën e vlerësimit.

⁷ Nuk përbëjnë shkak për skualifikim, por ndikojnë në procesin e vlerësimit të projekteve. Mospërcjellja e dokumentacionit, që përbën avantazh, vlerësohet me 0 pikë në tabelën e vlerësimit.

⁸ Nuk përbëjnë shkak për skualifikim, por ndikojnë në procesin e vlerësimit të projekteve. Mospërcjellja e dokumentacionit, që përbën avantazh, vlerësohet me 0 pikë në tabelën e vlerësimit.



PJESA II PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Qëllimi i projektit: Përshkruani shkurtimisht projektin, problematikën që ai adreson, si dhe argumentimin se si projekti i përgjigjet objektivit të përcaktuar në thirrje (*maksimumi 10 rreshta*).

[Shpjegoni ...]

Aktivitetet kryesore në realizimin e objektivit (*maksimumi 5 rreshta përshkrim për secilin aktivitet*).

1. Rekrutimi i 1 (një) ose më shumë punonjësve, juristëve për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti nga ana e organizatës.

2. Lidhja e kontratës së punës me organizatën jofitimprurëse të autorizuar, që përfiton financim dhe kryerja e pagesave mujore për pagat/sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për juristët që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti⁹.

3. Blerja e materialeve kancelarike/logjistike për mbarëvajtjen e punës në ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti.

4. Ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike parësore nga juristi i rekrutuar.

5.

6.

7.

8.

Shënim:

- 4 (katër) aktivitetet e para janë aktivitete të detyrueshme, në kuadër të përmbushjes së objektivit të përgjithshëm.

- Në projektpropozim mund të shtohen aktivitete të tjera, të cilat nuk mund të përfshihen në tabelën financiare të projektpropozimit.

A përmban projekti tregues objektivisht të verifikueshëm lidhur me rezultatet e aktiviteteve (targeti)? (*maksimumi 3 rreshta për secilin aktivitet*):

Aktiviteti 1:

Rezultatet e pritura dhe treguesit:

Aktiviteti 2:

Rezultatet e pritura dhe treguesit:

Aktiviteti 3:

Rezultatet e pritura dhe treguesit:

Aktiviteti 4:

Rezultatet e pritura dhe treguesit:

- **Shënim aktiviteti nr. 1: Juristët e rekrutuar duhet të kenë minimalisht 1 (një) vit eksperiencë pune në profesion.**

- **Shënim aktiviteti nr. 2: Paga për funksion nuk duhet të jetë më e madhe se kategoria e pagave të punonjësve me trajnim të posaçëm (kategoria IV-a) të miratuar në urdhrin nr. 59, datë 25.3.2019, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”.**

- **Shënim aktiviteti nr. 3: Çmimet për kancelaritë të jenë konform çmimeve reale të tregut.**

- **Shënim aktiviteti nr. 4: Targeti minimal është 25 raste në muaj, ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti. Një target më i lartë shërben si avantazh në kuadër të procesit të pikëzimit të projektpropozimeve për sa kohë ky i fundit është real dhe përmbushet nga ana e organizatës në procesin e monitorimit të kontratës së gantit.**

⁹ Paga për funksion nuk duhet të jetë më e madhe se kategoria e pagave të punonjësve me trajnim të posaçëm (kategoria IV-a), e miratuar në urdhrin nr. 59, datë 25.3.2019, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”.



PJESA III
KALENDARI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE

Muaji	Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti
Prill						
Maj						
Qershor						
Korrik						
Gusht						
Shtator						
Tetor						
Nëntor						
Dhjetor						
Janar						
Shkurt						
Mars						
Prill						

PJESA IV
PËRFTUESIT E DREJTPËRDREJTË NGA PROJEKTI

Nënshkrimi

Datë _____

ANEKS 3
PLANI I FINANCIAR I AKTIVITETEVE/LOGJISTIKËS DHE I PAGESAVE

Periudha: _____ deri në _____

Objektivi i përgjithshëm	Sigurimi i shërbimeve të ndihmës juridike parësore për kategoritë përfituese të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive.				
Aktiviteti nr. 1					
Rekrutimi i 1 (një) ose më shumë punonjësve, juristëve për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti nga ana e organizatës.	Procedura e rekrutimit ndiqet nga vetë organizata (nuk kostohej).				
Aktiviteti nr. 2	Numri i punonjësve të rekrutuar	Paga mujore bruto për secilin punonjës	Pagat bruto totale në muaj për të gjithë punonjësit	Paga e punonjësve për 12 muaj	Sqarime/shënime
Lidhja e kontratave dhe kryerja e pagesave mujore për juristët, që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti.	xx	xx	xx	xx	
Aktiviteti nr. 2.1	Numri i punonjësve	Kontributi i sigurimeve shoqërore/shëndetësore dhe i tatimit mbi të ardhurat për secilin punonjës	Sigurimet shoqërore shëndetësore dhe të tatimit mbi të ardhurat gjithsej në muaj	Kontributi i sigurimeve shoqërore/shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat për 12 muaj	Sqarime/shënime



Objekti i përgjithshëm	Sigurimi i shërbimeve të ndihmës juridike parësore për kategoritë përfituese të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive.				
Aktiviteti nr. 1					
Rekrutimi i 1 (një) ose më shumë punonjësve, juristëve për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti nga ana e organizatës.	Procedura e rekrutimit ndiqet nga vetë organizata (nuk kostohej).				
Aktiviteti nr. 2	Numri i punonjësve të rekrutuar	Paga mujore bruto për secilin punonjës	Pagat bruto totale në muaj për të gjithë punonjësit	Paga e punonjësve për 12 muaj	Sqarime/shënime
Kryerja e pagesave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për juristët, që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti.	xx	xx	xx	xx	
Aktiviteti nr. 3 Blerja e materialeve kancelarike/logjistike për mbarëvajtjen e punës në ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti.	Materialet	Sasia	Çmimi (referuar të çmimit të tregut)	Kostoja për 12 muaj	Sqarime/shënime
TOTAL					

Shembull referues (paga)

Nr.	Emër Mbiemër	Emërtesa sipas strukturës së miratuar	Kategori/klasa	Paga e grupit	Paga për funksion	Shtesa page për vjetërsi në punë			Paga maksimale bruto referuese
						Vite	%	Shtesa për vjetërsi	
1	Punonjës 1	Specialist	IV-a	14.000 11.000 10.000	49.000	1	2	280	63280
2	Punonjës 2	Specialist	IV-b	14.000 11.000 10.000	38.000	1	2	280	52280
3	Punonjës 3	Specialist	IV-c	14.000/ 11.000/ 10.000	29.500	1	2	280	43780

Baza ligjore referuese për llogaritjen e pagave dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat:

- Vendimi nr. 187, datë 8.3. 2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”.

- **Paga për funksion nuk duhet të jetë më e madhe se kategoria e pagave të punonjësve me trajnim të posaçëm (kategoria IV-a)** të miratuar në urdhrin nr. 59, datë 25.3.2019, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”.

- Ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Paga grupit, 14.000 lekë, i referohet grupit të diplomës “Master i shkencave”; 11.000 lekë i referohet “Masterit profesional”; dhe paga e grupit 10.000 lekë i referohet diplomës “Bachelor”, sipas legjislacionit për arsimin e lartë dhe lidhjes nr. 2, të vendimit 187, datë 8.3.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve ...”.

- Juristët e rekrutuar duhet të kenë minimalisht 1 (një) vit eksperiencë pune në profesion.



Shembull referues (materialet kancelarike/logjistike)

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia referuese	Çmimi mesatar referues
1	Dosje me qese, 80 fletë	copë	5	305
2	Makinë kapëse 24/6	copë	2	269
3	Tela për makina kapëse aktesh 24/6	kuti	5	30
4	Kapëse aktesh me veshë 25 mm	kuti	5	73
5	Kapëse aktesh nr. 28 mm	kuti	5	45
6	Zarfe 23x33 (A4)	copë	500	8
7	Agiendë ditore, afërsisht 17.2x24, min. 300 faqe	copë	2	288
8	Evidenciator me 4 ngjyra	pako	5	314
9	Stick Notes	pako	20	162
10	Qese A4	pako	5	382
11	Letër fotokopjeje 100gr/m ²	kuti	5	2,055
12	Makinë heqëse teli e vogël	copë	2	133
13	Dosje kartoni me numër	copë	100	14
14	Stilolapsa të thjeshtë me kapak	copë	100	22
15	Bojë printeri	copë	5	9,000
16	Kosha për letra zyre	copë	1	352
17	Materiale vizibiliteti – fletëpalosje	copë	1000	6
18	Stenda	copë	1	7,800
19	Postera	copë	50	600
20	Të tjera materiale kancelarie		X	-
TOTAL				

Theksojmë, që çmimet që do të paraqiten në tabelën financiare, të jenë konform çmimeve reale të tregut.

DEKLARATË TIP MBI FINANCIMIN E DYFISHTË

Unë, _____, në pozicionin e përfaqësuesit ligjor të organizatës

Deklaroj se:

Aplikuesi: _____
(emri i OJF-së)

Nuk përfiton burime të tjera financimi për të njëjtin aktivitet të ofrimit të ndihmës juridike parësore.

Ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike parësore

“Ndihmë juridike” është shërbimi juridik falas dhe shërbimet e tjera të parashikuara në këtë ligjin nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, për personat që përmbushin kriteret e këtij ligji, të cilat garantohen dhe financohen nga shteti.

“Ndihmë juridike parësore” është:

- dhënia e informacioneve, në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor;

- dhënia e këshillimit;

- dhënia e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe të zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve;

- dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme, për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore;

- përfaqësimi përpara organeve administrative; dhe

- dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike, që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.



Deklaroj se i gjithë informacioni që kam vënë në dispozicion, përmes këtij aplikimi, është i vërtetë dhe i saktë. Jam i informuar se përbën shkelje në kuptim të nenit 32, të ligjit nr. 111/2017, dhe të legjislacionit penal të Republikës së Shqipërisë:

- dhënia e një informacioni/deklarimi të pasaktë/të pavërtetë;
- dhënia e dokumenteve false.

Deklaroj dhe pranoj, se, nëse vërtetohet pasaktësia/falsiteti i një informacioni dhe/ose një dokumenti, ndaj meje mund të ndërmerren masat e nevojshme të përgjegjësisë për çdo kosto të shkaktuar si rezultat i përfitimit pa të drejtë, për shkak të pasaktësisë/pavërtetësisë apo falsitetit të provuar. Konkretisht, përmes këtij deklarimi, pranoj se në rast të pasaktësisë dhe/ose falsitetit të një informacioni ose dokumenti, do të jem i detyruar të rimbursoj shpenzimet. Deklaroj dhe pranoj se të gjitha të dhënat e vëna në dispozicion nga unë, mund të verifikohen për efekt të saktësisë, vërtetësisë dhe efektshmërisë së tyre, lidhur me aplikimin tim dhe se ky deklarim mund të shërbejë si autorizim për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas për të ndërmarrë çdo veprim me qëllim verifikimin e të dhënave.

Vendi dhe data

Emri i plotë dhe nënshkrimi i përfaqësuesit të OJF-së

FORMULAR TIP DEKLARIMI (I KONFLIKTIT TË INTERESIT)

Deklaruesi: _____

Unë, _____, në pozicionin _____, anëtar i organeve vendimmarrëse/përfaqësues ligjor/punonjës i organizatës _____, deklaroj se nuk jam në kushtet e konfliktit të interesit, që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, dhe legjislacioni në fuqi, që cenon zhvillimin e drejtë të procesit të përzgjedhjes së aplikimeve për financim me titullarin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë _____

Nënshkrimi _____



**METODOLOGJIA MBI PROCEDURAT
E FINANCIMIT TË ORGANIZATAVE
JOFITIMPRURËSE TË AUTORIZUARA
NGA MINISTRI I DREJTËSISË¹⁰**



**DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE
FALAS**

Rruga “Jordan Misja”, Njësia Administrative nr.
9, godina nr. 3, Tiranë
www.ndihmajuridike.gov.al
dnjf@drejtesia.gov.al

Tabela e përmbajtjes

Hyrje

Objektivat e përfitimit financiar

Etapat në të cilat planifikohen fondet për
financimin e organizatave jofitimprurëse të
autorizuara

Plani vjetor i financimit i organizatave
jofitimprurëse të autorizuara

Shuma e përfitimit financiar për vitin fiskal

Objektivat e përfitimit financiar, sipas
objektivave të identifikuar

Numri i përafërt i organizatave, që mund të
përfshihen në procesin e përzgjedhjes

Koha e hapjes së thirrjes për aplikime

Koha e fillimit të zbatimit të ofrimit të ndihmës
juridike parësore të garantuar nga shteti

Roadmap mbi financimin e organizatave
jofitimprurëse të autorizuara

Hapja e thirrjes së përgjithshme për financimin
e organizatave jofitimprurëse të autorizuara

Aneks 1. Lista e dokumenteve të nevojshme për
aplikim

Aneks 2. Formular tip i aplikimit

Aneks 3. Plani financiar i aktiviteteve/i
logjistikës dhe pagesave

Aneks 4. Format i raportit të realizimit të
projektit, sipas fazave (pas lidhjes së kontratës)

Ngritja e Komisionit të Vlerësimit dhe i
Komisionit të Ankimit

Deklarata e paanshmërisë dhe konfidencialitetit
Vlerësimi paraprak i projektpropozimeve
Renditja dhe përzgjedhja e projektpropozimeve
Tabelë vlerësimi përmbledhëse e
projektpropozimit

Hyrje

Kjo metodologji shërben si një udhëzues i cili
do t'u mundësojë organizatave jofitimprurëse të
autorizuara, si dhe Komisionit të
Vlerësimit/Komisionit të Ankimit, që të zbatojnë
në mënyrë të unifikuar kriteret; procedurat dhe
mënyrën e vlerësimit të projektpropozimeve të
përcjella për financime nga buxheti i shtetit.

Në përpilimin e këtij akti janë marrë për bazë:
“Metodologjia për alokimin e fondeve për
organizatat e shoqërisë civile”, përgatitur nga
Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
(UNDP), me mbështetjen financiare të Bashkimit
Evropian; rregullorja e Ministrisë së Financave të
Kosovës nr. 04/2017, “Mbi kriteret, standardet dhe
procedurat e financimit publik të OJQ-ve”; si dhe
aktet e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë
Civile, të cilat marrin për bazë praktikën e mira
rajonale dhe ndërkombëtare që mundësojnë
zbatimin me transparencë të thirrjeve publike për
financimin e projekteve dhe programeve të OJF-ve
përmes fondeve publike.

Bazuar në nenin 15, pika 3, të ligjit nr.
111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga
shteti”, organizatat jofitimprurëse të autorizuara për
dhënien e ndihmës juridike parësore përfitojnë
financime nga buxheti i shtetit, pas një procesi
konkurrues dhe transparent përzgjedhjeje.
Procedura, rregullat e përzgjedhjes së organizatave
jofitimprurëse të autorizuara, që përfitojnë
financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e
financimit të tyre përcaktohen në VKM-në nr. 110,
datë 6.3.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe
të rregullave të përzgjedhjes së organizatave
jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e
ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti,
që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe
mënyra e financimit të tyre”.

Të gjitha organizatat jofitimprurëse të
autorizuara për t'u kualifikuar për të përfituar
financime, duhet të plotësojnë kriteret e
përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në
pikën 6, të VKM-së nr. 110, datë 6.3.2019, “Për
përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të

¹⁰ Miratuar me urdhrin nr. 5, datë 18.1.2022, të drejtorit të
përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, “Për
miratimin e metodologjisë mbi procedurat e financimit të
organizatave jofitimprurëse të autorizuara”.



përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”, si më poshtë vijon:

a) Krite të përgjithshme:

i. të kenë marrë autorizimin nga ministri i Drejtësisë, për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti;

ii. të mos kenë dy burime të njëjta financimi për të njëjtin aktivitet;

iii. të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi, që cenon zhvillimin e drejtë të procesit të përzgjedhjes me drejtorin e ndihmës juridike falas.

b) Krite të veçanta:

i. projektpropozimin, i cili përmban të dhënat teknike-financiare për ofrimin e shërbimit, qëllimin, objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara, përfituesit e drejtpërdrejtë;

ii. të dhëna për personelin, duke specifikuar detyrat dhe duke siguruar jetëshkrimin e tyre;

iii. të dëshmojnë se kanë përvojë në realizimin e shërbimeve të ngjashme, duke siguruar dokumente dhe të dhëna të realizimit të shërbimeve të ngjashme në të kaluarën (kontrata granti me objekt të ngjashëm).

Organizata jofitimprurëse e autorizuar duhet të dëshmojë se i plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, duke dorëzuar dokumentet përkatëse, sipas thirrjes publike. Në rast të mosplotësimit të një prej kriteve të përgjithshme dhe të veçanta, shoqëruar me dokumentet përkatëse të thirrjes, aplikimi konsiderohet i paplotë dhe, si i tillë, nuk kualifikohet për përfitimin financiar.

Objektivat e përfitimit financiar

Objekti i përgjithshëm: *Sigurimi i shërbimeve të ndihmës juridike parësore për kategoritë përfituese të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive.*

Organizata jofitimprurëse e autorizuar, përgjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, do të ushtrojë një shumëllojshmëri shërbimesh ligjore në fushën e ndihmës juridike parësore, si vijon:

i. dhënia e informacioneve, në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor;

ii. dhënia e këshillimit;

iii. dhënia e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe të zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve;

iv. dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore;

v. përfaqësimi përpara organeve administrative; dhe

vi. dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike, që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

Duke marrë në konsideratë numrin mesatar të rasteve të raportuara nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore, gjatë periudhës së zbatimit të këtij projekti duhet të synohet ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore, minimalisht **për 300 qytetarë** (25 raste në muaj).

- Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ndihmë juridike parësore nënkuptohet vetëm ndihma juridike e dhënë fizikisht për qytetarët (përmes nënshkrimit të formularëve tip të deklarimit) dhe jo ndihma juridike *online*.

- Referuar kësaj thirrjeje, ndihma juridike do të ofrohet pranë zyrës/ambienteve në të cilën operon organizata jofitimprurëse e autorizuar.

- Referuar kësaj thirrjeje, ndihma juridike do të ofrohet për të gjitha kategoritë përfituese të ligjit nr. 111/2017, pa u ndalur në trajtimin e rasteve të veçanta, sipas objektivit të veprimtarisë së OJF-ve.

- Referuar kësaj thirrjeje, nuk financohet zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuëse apo i edukimit ligjor të publikut, por inkurajohet fakti që këto aktivitete të përfshihen në projektpropozim, si pjesë e detyrave funksionale të juristit/juristëve të rekrutuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore.

Në kuadër të përmbushjes së projektpropozimit, aktivitetet kryesore që duhen ndërmarrë janë:

1. **Rekrutimi i 1 (një) ose më shumë punonjësve**, juristëve për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti nga ana e organizatës;

2. Lidhja e kontratës së punës me organizatën jofitimprurëse të autorizuar, që përfiton financim dhe **kryerja e pagesave mujore për pagat/sigurimet shoqërore dhe shëndetësore** për



juristët që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti;

3. **Blerja e materialeve kancelarike/logjistike** për mbarrëvajtjen e punës në ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti.

4. **Ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike parësore nga juristi i rekrutuar.**

Etapat në të cilat planifikohen fondet për financimin e organizatave jofitimprurëse të autorizuar

1. Në zbatim të VKM-së “Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm”, për një periudhë 3-vjeçare (trevjeçare), Ministria e Drejtësisë përcakton tavanet e shpenzimeve për çdo institucion varësie.

2. Në zbatim të udhëzimit të ministrit të Financave për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas planifikon në mbështetje të objektivave, fondet për financimin e OJF-ve, sipas fazave të hartimit të pasqyrave të projektbuxhetit afatmesëm.

3. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas deklaron në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar Shqiptar (AFMIS) fondet, sipas programit buxhetor afatmesëm.

Referuar hapave të sipërcituar, bëhet i mundur planifikimi dhe çelja e fondeve në muajin janar të vitit pasardhës, kohë në të cilën, në zbatim të VKM-së nr. 110, datë 6.3.2019, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas bën publike në faqen zyrtare të saj planin vjetor të financimit të OJF-ve të autorizuar.

Plani vjetor i financimit i organizatave jofitimprurëse të autorizuar

Në pikën 4, të VKM-së 110/2019, parashikohet shprehimisht, se: “Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, brenda 1 muaji nga miratimi i buxhetit, bën publike në faqen zyrtare të saj planin vjetor të financimit, që përmban:

a) shumën e përfitimit financiar për vitin fiskal;

b) objektivat e përfitimit financiar, sipas nevojave të identifikuar;

c) numrin e përafërt të organizatave jofitimprurëse të autorizuar, që mund të përfshihen në procesin e përzgjedhjes;

d) kohën e hapjes së thirrjes për aplikime; dhe

d) kohën e fillimit të zbatimit të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti.”

Shuma e përfitimit financiar për vitin fiskal

Buxheti i miratuar ka përcaktuar për dhënien e ndihmës juridike parësore, për individët që plotësojnë kushtet, në zbatim të ligjit për ndihmën juridike falas, në total, është në vlerën 8,000,000 lekë.

Objektivat e përfitimit financiar sipas objektivave të identifikuar

Dhënia e ndihmës juridike parësore për kategoritë përfituese të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive.

Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ndihmë juridike parësore nënkuptohet vetëm ndihma juridike e dhënë fizikisht për qytetarët (përmes nënshkrimit të formularëve tip të deklaramit) dhe jo ndihma juridike online.

Ndihma juridike do të ofrohet pranë zyrës/ambienteve në të cilën operon organizata jofitimprurëse e autorizuar.

Ndihma juridike do të ofrohet për të gjitha kategoritë përfituese të ligjit nr. 111/2017, pa u ndalur në trajtimin e rasteve të veçanta, sipas objektivit të veprimtarisë së OJF-ve.

Numri i përafërt i organizatave që mund të përfshihen në procesin e përzgjedhjes

Të gjitha organizatat jofitimprurëse të autorizuar nga ministri i Drejtësisë mund të përfshihen në procedurën e përzgjedhjes.

Në kushtet kur, referuar pikës 21 të VKM-së nr. 110/2019, çdo organizatë jofitimprurëse e autorizuar, e përzgjedhur, nuk mund të përfitojë më shumë se 20% të buxhetit të planifikuar për financimin e dhënies së ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti për organizatat jofitimprurëse. Numri i organizatave, që mund të mbulohen me fondet e vitit 2022, është të paktën 5 (pesë) organizata.

Do të shpallen fituese të financimit, organizatat jofitimprurëse me pikët më të larta vlerësuar nga komisioni përkatës.

Vlera maksimale e financimit për një organizatë sipas VKM-së nr. 110/2019	Numri minimal i organizatave të mund të përfitojnë financim
20% e 8.000.000 lekë= 1.600.000 lekë	8.000.000 lekë/1.600.000 lekë= 5 organizata



Koha e hapjes së thirrjes për aplikime:

Referuar VKM-së 110/2019, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas njofton në faqen zyrtare të institucionit dhe pranë Buletinit të Njoftimeve Zyrtare, çdo fillim viti kalendarik.

Si pasojë, hapja e thirrjes, sipas pikës 4, të VKM-së nr. 110/2019, do të realizohet brenda 1 (një) muaji nga miratimi i buxhetit vjetor.

Koha e fillimit të zbatimit të ofrimit të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti

Nëse u referohemi afateve procedurale të përcaktuara në VKM-në nr. 110/2019, lidhja e kontratave të financimit parashikohet të realizohet brenda 3 muajve nga shpallja e thirrjes, sipas përcaktimeve të planit të punës mbi financimin, në vijim.

Plani i punës mbi financimin e organizatave jofitimprurëse të autorizuar

Vlerësimi/analiza	Struktura përgjegjëse	Hapat procedurale	Mënyra veprimit	Afatet kohore
Plani vjetor i financimit të OJF-ve të autorizuar nga ministri i Drejtësisë	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas 1. Drejtoria e Financave, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse 2. Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore	Pas hyrjes në fuqi të ligjit për Buxhetin, hartohet plani vjetor i financimit të OJF-ve të autorizuar, sipas përcaktimeve të pikës 4, të VKM-së nr. 110/2019.	Publikimi i planit vjetor të financimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas	Janar 2022
Hapja e thirrjes së përgjithshme për financimin e OJF-ve të autorizuar	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas 1. Drejtoria e Financave, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse 2. Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore	Pas publikimit të planit vjetor të financimit hapet thirrja për financimin e OJF-ve të autorizuar, sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 5, të VKM-së nr. 110/2019.	Publikimi i thirrjes në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe pranë Buletinit të Njoftimeve Zyrtare	Janar 2022
Ngritja e Komisionit Vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për financimin e OJF-ve; Komisioni i ankimimit për shqyrtimin e ankesave për shkelje të qëllimshme të procedurës së shqyrtimit si dhe sekretariatit teknik mbështetës.	Ministria e Drejtësisë Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas	Përcjellja e shkresave dërguar MD-së për caktimin e 2 anëtarëve në KVO dhe të 2 anëtarëve në KA, sipas VKM-së nr. 110/2019. Ngritja e KVO-së dhe KA me urdhër të ministrit të Drejtësisë.	Institucional, shkresor.	Shkurt 2022
Analizimi i dokumentacionit Teknik/administrativ të organizatave jofitimprurëse të autorizuar	Komisioni Vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për financimin e OJF-ve	Brenda 10 ditëve nga mbyllja e thirrjes publike për aplikim.	KVO-ja shqyrton aplikimet për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta	10 ditë mbas mbylljes së thirrjes
Ndjekja e procedurës së ankimit	Komisioni i ankimimit për shqyrtimin e	Vlerësimi i ankimimit, nëse ka shkaqe ligjore dhe është paraqitur brenda afateve.	Nxjerrja e vendimit të arsyetuar për pranimin ose	15 ditë nga data e paraqitjes



	ankesave për shkelje të qëllimshme të procedurës së shqyrtimit		mospranimin e ankimit	së ankimimi. Njoftimi i arsyetuar i vendimit dhe publikimi në faqen zyrtare të DNJF, brenda 2 ditëve nga marrja e vendimit.
Shpallja e fitueseve	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas	Lidhja e kontratës 1-vjeçare të financimit, sipas përcaktimeve të pikës 20, të VKM-së nr. 110/2019 dhe shtojcës së urdhrit nr. 226, datë 25.3.2019, të ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”.	Kontratë individuale për çdo OJF të shpallur fituese pas plotësimit të kriterëve	Mars 2022

Hapja e thirrjes së përgjithshme për financimin e organizatave jofitimprurëse të autorizuar

ANEKS 1

LISTA E DOKUMENTEVE TË NEVOJSHME PËR APLIKIM

Përbën shkak automatik skualifikimi, mungesa e dokumentacionit, sipas kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta, përveç dokumentacionit që përbën avantazh (citur).

Kritere të përgjithshme mbi organizimin dhe funksionimin e OJF-ve të autorizuar
1. Statuti i organizatës jofitimprurëse të autorizuar (i përditësuar), ku objekti i veprimtarisë së organizatës të jetë dhe ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike; 2. Akti i themelimit të organizatës jofitimprurëse të autorizuar (i përditësuar); 3. Aktet e emërimit të organeve vendimmarrëse, duke përfshirë edhe aktin për caktimin e përfaqësuesit ligjor të organizatës jofitimprurëse (i përditësuar); 4. Dokumenti i regjistrimit në organin tatimor (NIPT), ku objekti i veprimtarisë së organizatës të jetë dhe ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike; 5. Numri unik i identifikimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹¹. 6. Akti i autorizimit nga ministri i Drejtësisë për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti.
Kritere të veçanta – Kapacitetet e burimeve njerëzore/personelit
1. ID-ja e anëtarëve të organeve vendimmarrëse dhe e përfaqësuesit ligjor të organizatës; 2. ID-ja e punonjësve të organizatës; 3. CV-ja e anëtarëve të organeve vendimmarrëse dhe e përfaqësuesit ligjor të organizatës; 4. CV-ja e punonjësve të organizatës (avokatë; jurist; financier dhe çdo punonjës tjetër që ka rol në plotësimin e objektivave të projektit); 5. Përshkrimet e punës dhe kontratat e punës të punonjësve të organizatës (avokatë, jurist, financier dhe çdo punonjës tjetër që ka rol në plotësimin e objektivave të projektit); 6. Certifikatat e trajnimeve të punonjësve të lartpërmendur, në funksion të zbatimit të objektivave të projektit (nëse ka përbën avantazh në procesin e pikëzimit¹²); 7. Vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata, se anëtarët e organeve vendimmarrëse dhe përfaqësuesit ligjorë të organizatës, nuk janë në proces hetimi apo gjykimi për çështje që cenojnë besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike; 8. Vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për punonjësit e organizatës, që nuk janë në proces hetimi apo gjykimi për çështje që cenojnë besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike; 9. Deklaratë për mosekzistencën e ndonjë konflikti interesi, që cenon zhvillimin e drejtë të procesit të përzgjedhjes me

¹¹ Referuar përcaktimeve të ligjit nr. 80/2021, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”. Mungesa e numrit unik nuk është shkak për skualifikim, duke marrë në konsideratë kohën e shkurtër që nga implementimi i ligjit dhe vonesat në zbatimin e tij.

¹² Nuk përbëjnë shkak për skualifikim, por ndikojnë në procesin e vlerësimit të projekteve. Mospërcjellja e dokumentacionit, që përbën avantazh, vlerësohet me 0 pikë në tabelën e vlerësimit.



titullarin e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas nga anëtarët e organeve vendimmarrëse dhe përfaqësuesit ligjorë të organizatës;
10. Deklaratë për mosekzistencën e ndonjë konflikti interesi, që cenon zhvillimin e drejtë të procesit të përzgjedhjes me titullarin e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas nga punonjësit e organizatës.
Kritere të veçanta – Aktivitet afatgjatë të organizatës
1. Certifikatë pronësie e ambientit ku ushtrohet aktiviteti ose kontratë qiraje; 2. Kopje të inventarëve fizikë të pajisjeve (kompjuter, printer, tavolina, karrige etj.), që disponon organizata në funksion të ushtrimit të aktivitetit të punonjësve ose çdo dokument tjetër, që vërteton gjendjen e asetëve në funksion të veprimtarisë së OJF-së; 3. Dokument (foto), që vërteton faktin se vendndodhja e organizatës është lehtësisht e aksesueshme nga qytetarët dhe mjediset ku do të ofrohet shërbimi të ofrojnë mundësinë e aksesimit nga personat me aftësi të kufizuara (përbën avantazh) ¹³ . 4. Dokument (foto), që vërteton faktin se organizata mundëson një ambient të veçuar për trajnimin e rasteve të shërbimit të ndihmës juridike parësore me një karakter sensitiv (përbën avantazh) ¹⁴ .
Kritere të veçanta – Kapaciteti financiar i organizatës
1. Kopje të kontratave të grantit me partnerë, në kuadër të zbatimit të projekteve të ngjashme të tre vjetëve të fundit; 2. Kopje të raportimeve përfundimtare narrative dhe financiare të realizimit të granteve me partnerë, në kuadër të zbatimit të projekteve të ngjashme të tre vjetëve të fundit; 3. Vërtetimi nga partnerët për realizimin e suksesshëm të kontratave të grantit (përbën avantazh) ¹⁵ ; 4. Vërtetim nga organet tatimore, që organizata nuk ka detyrime tatimore të papaguara (i përditësuar); 5. Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për deklarimin e pagesave të kontributeve për sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat për të gjithë punonjësit (i përditësuar); 6. Listëpagesa e punonjësve, sipas legjislacionit në fuqi (borderoja e pagave e 3 (tre) muajve të fundit) shoqëruar me dokumentin që vërteton pagesën; 7. Vërtetim i llogarisë bankare të organizatës; 8. Pasqyrat financiare të vitit të fundit të nënshkruara nga hartuesi i pasqyrave financiare dhe të nënshkruara nga drejtuesi i organizatës, të konfirmuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; 9. Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, që organizata nuk është në proces falimentimi; 10. Raport vlerësues përfundimtar i kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe financiare të OJF-së i ushtruar nga shoqëri të licencuara auditimi (përbën avantazh) ¹⁶ ; 11. Deklaratë e organizatës, që nuk përfiton burime të tjera financimi për të njëjtin aktivitet, për të cilin është duke aplikuar pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas; 12. Oferta financiare e projektut sipas thirrjes.
Kritere të veçanta – Performanca e organizatës që nga momenti i autorizimit për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga ministri i Drejtësisë
1. Deklaratë mbi numrin total të rasteve të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, të raportuara pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, që nga momenti i autorizimit nga ministri i Drejtësisë (përbën avantazh) ¹⁷ ; 2. Letra vlerësimi nga të paktën 2 (dy) subjekte përfituese nga shërbimet e ndihmës juridike parësore (përbën avantazh) ¹⁸ .

¹³ Nuk përbëjnë shkak për skualifikim, por ndikojnë në procesin e vlerësimit të projekteve. Mospërcjellja e dokumentacionit, që përbën avantazh, vlerësohet me 0 pikë në tabelën e vlerësimit.

¹⁴ Nuk përbëjnë shkak për skualifikim, por ndikojnë në procesin e vlerësimit të projekteve. Mospërcjellja e dokumentacionit, që përbën avantazh, vlerësohet me 0 pikë në tabelën e vlerësimit.

¹⁵ Nuk përbëjnë shkak për skualifikim, por ndikojnë në procesin e vlerësimit të projekteve. Mospërcjellja e dokumentacionit, që përbën avantazh, vlerësohet me 0 pikë në tabelën e vlerësimit.

¹⁶ Nuk përbëjnë shkak për skualifikim, por ndikojnë në procesin e vlerësimit të projekteve. Mospërcjellja e dokumentacionit, që përbën avantazh, vlerësohet me 0 pikë në tabelën e vlerësimit.

¹⁷ Nuk përbëjnë shkak për skualifikim, por ndikojnë në procesin e vlerësimit të projekteve. Mospërcjellja e dokumentacionit, që përbën avantazh, vlerësohet me 0 pikë në tabelën e vlerësimit.

¹⁸ Nuk përbëjnë shkak për skualifikim, por ndikojnë në procesin e vlerësimit të projekteve. Mospërcjellja e dokumentacionit, që përbën avantazh, vlerësohet me 0 pikë në tabelën e vlerësimit.



ANEKS 2
FORMULAR TIP I APLIKIMIT

PJESA I
INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Titulli i projektit	
Emri i organizatës jofitimprurëse	
Statusi ligjor (së bashku me ndryshimet që kanë pësuar aktet themelore të organizatës, duke bashkëngjitur vendimet përkatëse të gjykatës nr.)	Numri i vendimit dhe data e regjistrimit në gjykatë; NIPT-i Emri i Bankës Numri IBAN Nr. i llogarisë bankare (në lek)
Autorizim i ministrit të Drejtësisë	Nr. dhe data e autorizimit nga ministri i Drejtësisë.
Adresa:	
E-mail:	
Website:	
Vendi/et ku zbatohet projekti	
Personi i kontaktit	
Pozita në organizatë	
Fondet e kërkuara nga DNJF-ja	
Përshkrim i projekteve të ngjashme të tre vjetëve të fundit në rend zbritës	
Nënshkrimi i drejtuesit/përfaqësuesit të organizatës	

PJESA II
PËRSHKRIMI I PROJEKTTIT

Qëllimi i projektit: Përshkruani shkurtimisht projektin, problematikën që ai adreson, si dhe argumentimin se si projekti i përgjigjet objektivit të përcaktuar në thirrje (*maksimumi 10 rreshta*).

[Shpjegoni ...]

Aktivitetet kryesore realizimin e objektivit (*maksimumi 5 rreshta përshkrim për secilin aktivitet*):

1. Rekrutimi i 1 (një) ose më shumë punonjësve, juristëve për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti nga ana e organizatës;

2. Lidhja e kontratës së punës me organizatën jofitimprurëse të autorizuar, që përfiton financim dhe kryerja e pagesave mujore për pagat/sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për juristët që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti¹⁹;

3. Blerja e materialeve kancelarike/logjistike për mbarëvajtjen e punës në ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti;

4. Ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike parësore nga juristi i rekrutuar;

5.;

6.;

7.;

8.

Shënim:

- 4 (katër) aktivitetet e para janë aktivitete të detyrueshme në kuadër të përmbushjes së objektivit të përgjithshëm.

- Në projektpropozim mund të shtohen aktivitete të tjera, të cilat nuk mund të përfshihen në tabelën financiare të projektpropozimit.

A përmban projekti tregues objektivisht të verifikueshëm lidhur me rezultatet e aktiviteteve (targeti)? (*maksimumi 3 rreshta për secilin aktivitet*):

Aktiviteti 1:

Rezultatet e pritura dhe treguesit:

Aktiviteti 2:

Rezultatet e pritura dhe treguesit:

Aktiviteti 3:

Rezultatet e pritura dhe treguesit:

¹⁹ Paga për funksion nuk duhet të jetë më e madhe se kategoria e pagave të punonjësve me trajnim të posaçëm (kategoria IV-a) të miratuar në urdhrin nr. 59, datë 25.3.2019, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas".

**Aktiviteti 4:**

Rezultatet e pritura dhe treguesit:

- **Shënim aktiviteti nr. 1:** Juristët e rekrutuar duhet të kenë minimalisht 1 (një) vit eksperiencë pune në profesion.

- **Shënim aktiviteti nr. 2:** Paga për funksion nuk duhet të jetë më e madhe se kategoria e pagave të punonjësve me trajnim të posaçëm (kategoria IV-a) të miratuar në urdhrin nr. 59, datë 25.3.2019, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”.

- **Shënim aktiviteti nr. 3:** Çmimet për kancelaritë të jenë konform çmimeve reale të tregut.

- **Shënim aktiviteti nr. 4:** Targeti minimal është 25 raste në muaj, ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti. Një target më i lartë shërben si avantazh, në kuadër të procesit të pikëzimit të projektpropozimeve, për sa kohë ky i fundit është real dhe përmbushet nga ana e organizatës në procesin e monitorimit të kontratës së gantit.

PJESA III
KALENDARI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE

Muaji	Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti
Mars						
Prill						
Maj						
Qershor						
Korrik						
Gusht						
Shtator						
Tetor						
Nëntor						
Dhjetor						
Janar						
Shkurt						
Mars						

PJESA IV
PËRFTUESIT E DREJTPËRDREJTË NGA PROJEKTI

Nënshkrimi _____

Date _____

ANEKS 3
PLANI I FINANCIAR I AKTIVITETEVE/LOGJISTIKËS DHE PAGESAVE

Periudha: _____ deri në _____

Objektivi i përgjithshëm	Sigurimi i shërbimeve të ndihmës juridike parësore për kategoritë përfituese të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive.				
Aktiviteti nr. 1					
Rekrutimi i 1 (një) ose më shumë punonjësve, juristëve për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti nga ana e organizatës	Procedura e rekrutimit ndiqet nga vetë organizata (nuk kostohej).				
Aktiviteti nr. 2	Numri i punonjësve të rekrutuar	Paga mujore bruto për secilin punonjës	Pagat bruto totale në muaj për të gjithë punonjësit	Paga e punonjësve për 12 muaj	Sqarime/shënime
Lidhja e kontratave dhe kryerja e pagesave mujore për juristët që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti.	xx	xx	xx	xx	
Aktiviteti nr. 2.1	Numri i punonjësve	Kontributi i sigurimeve shoqërore/shëndetësore	Sigurimet shoqërore	Kontributi i sigurimeve shoqërore/shëndetësore	Sqarime/shënime



Objektivi i përgjithshëm	Sigurimi i shërbimeve të ndihmës juridike parësore për kategoritë përfituese të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive.				
Aktiviteti nr. 1					
Rekrutimi i 1 (një) ose më shumë punonjësve, juristëve për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti nga ana e organizatës	Procedura e rekrutimit ndiqet nga vetë organizata (nuk kostohej).				
Aktiviteti nr. 2	Numri i punonjësve të rekrutuar	Paga mujore bruto për secilin punonjës	Pagat bruto totale në muaj për të gjithë punonjësit	Paga e punonjësve për 12 muaj	Sqarime/shënime
		dhe tatimit mbi të ardhurat për secilin punonjës	shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat gjithsej në muaj	dhe tatimit mbi të ardhurat për 12 muaj	
Kryerja e pagesave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për juristët që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti	xx	xx	xx	xx	
Aktiviteti nr. 3 Blerja e materialeve kancelarike/logjistike për mbarëvajtjen e punës në ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti	Materialet	Sasia	Çmimi (referuar çmimit të tregut)	Kostoja për 12 muaj	Sqarime/shënime
TOTAL					

Shembull referues (paga)

Nr.	Emër Mbiemër	Emërtesa sipas strukturës së miratuar	Kategori/klasa	Paga e grupit	Paga për funksion	Shtesa page për vjetërsi në punë			Paga maksimale bruto referuese
						Vite	%	Shtesa për vjetërsi	
1	Punonjës 1	Specialist	IV-a	14.000 11.000 10.000	49.000	1	2	280	63280
2	Punonjës 2	Specialist	IV-b	14.000 11.000 10.000	38.000	1	2	280	52280
3	Punonjës 3	Specialist	IV-c	14.000/ 11.000/ 10.000	29.500	1	2	280	43780

Baza ligjore referuese për llogaritjen e pagave dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat:

- Vendimi nr. 187, datë 8.3. 2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, Aparatet e Ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”.

- **Paga për funksion nuk duhet të jetë më e madhe se kategoria e pagave të punonjësve me trajnim të posaçëm (kategoria IV-a)** të miratuar në urdhrin nr. 59, datë 25.3.2019, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”.

- Ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, paga e grupit 14.000 lekë i referohet grupit të diplomës “Master i shkencave”; 11.000 lekë i referohet “Masterit profesional” dhe paga e grupit 10.000 lekë i referohet diplomës “Bachelor”, sipas legjislacionit për arsimin e lartë dhe lidhjes nr. 2 të vendimit 187, datë 8.3.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve ...”.

- Juristët e rekrutuar duhet të kenë minimalisht 1 (një) vit eksperiencë pune në profesion



Shembull referues (materialet kancelarike/logjistike):

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia referuese	Çmimi mesatar referues
1	Dosje me qese 80 fletë	copë	5	305
2	Makinë kapëse 24/6	copë	2	269
3	Tela për makina kapëse aktesh 24/6	kuti	5	30
4	Kapëse aktesh me veshe 25 mm	kuti	5	73
5	Kapëse aktesh nr. 28 mm	kuti	5	45
6	Zarfe 23x33 (A4)	copë	500	8
7	Agjendë ditore afërsisht 17.2x24, min. 300 faqe	copë	2	288
8	Evidenciator me 4 ngjyra	pako	5	314
9	Stick Notes	pako	20	162
10	Qese A4	pako	5	382
11	Letër fotokopje, 100 gr/m ²	kuti	5	2,055
12	Makinë heqëse teli e vogël	copë	2	133
13	Dosje kartoni me numër	copë	100	14
14	Stilolapsa të thjeshtë me kapak	copë	100	22
15	Boje printeri	copë	5	9,000
16	Kosha për letra zyre	copë	1	352
17	Materiale vizibiliteti – fletë palosjeje	copë	1000	6
18	Stenda	copë	1	7,800
19	Postera	copë	50	600
20	Të tjera materiale kancelarie		X	-
TOTAL				

Theksojmë që çmimet që do të paraqiten në tabelën financiare të jenë konform çmimeve reale të tregut.

ANEKS 4

FORMATI I RAPORTIT TË REALIZIMIT TË PROJEKTIT SIPAS FAZAVE
(PAS LIDHJES SË KONTRATËS)

Objektivat	Targeti sipas projekt-propozimit	Realizimi i targetit për x-mujorin e parë	Llogaria ekonomike A	Sasia e pagesës së autorizuar, sipas fazave (faza e parë, dytë, tretë) B	Realizimi aktual i projektit D	Balanca E= (B-D)	Shënime (dokumente të dorëzuara)
Aktiviteti nr. 1							
Aktiviteti nr. 1.1							
Aktiviteti nr. 2							

Ngritja e Komisionit të Vlerësimit dhe e Komisionit të Ankimit

Mënyra e ngritjes, mbledhjes dhe funksionimit të Komisionit të Vlerësimit dhe e Komisionit të Ankimit përcaktohet në mënyrë të detajuar në VKM-në nr. 110/2019, si dhe në dhe kreun 6 të “Rregullores së brendshme” të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, miratuar me urdhrin nr. 393, datë 23.11.2020, të ministrit të Drejtësisë.

Deklarata e paanshmërisë dhe konfidencialitetit

Të gjithë anëtarët e Komisionit të vlerësimit duhet të nënshkruajnë një **deklaratë me shkrim të paanshmërisë dhe konfidencialitetit**. Ky akt i detyron të ruajnë konfidencialitet të plotë të informacionit që përmbajnë projektpropozimet, si dhe paanshmëri në procesin e vlerësimit të projektit. Nënshkrimi i deklaratës garanton

integritetin e të gjithë informacionit brenda procesit të vlerësimit deri sa rezultatet të botohen dhe të vihen në dispozicion të publikut të gjerë. Kjo mbron interesin e aplikantëve, si dhe të gjithë pjesëtarëve të tjerë në këtë proces.

Vlerësimi paraprak i projektpropozimeve

Hapi i parë në procesin e vlerësimit, përpara se të bëhet shqyrtimi i hollësishëm i projektpropozimeve të dorëzuara, është verifikimi nëse të gjithë aplikantët i kanë plotësuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në thirrje. Komisioni kontrollon nëse në aplikim është përfshirë dokumentacioni i detyrueshëm. Në rast se projektpropozimi nuk i plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, si dhe nuk ka përcjellë dokumentacionin e detyrueshëm, ai përjashtohet nga vlerësimi i mëtejshëm dhe shpallet i skualifikuar. Të gjitha



projektpropozimet regjistrohen më vete dhe mbahet një procesverbal ku përshkruhen mangësitë. Çdo procesverbal nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit.

Renditja dhe përzgjedhja e projektpropozimeve

Anëtarëve të komisionit iu jepet tabela e vlerësimit, që përbëhet nga kritere dhe nënkritere të paraqitura në formën e një tabele. Pas kësaj

duhet të fillojë procesi i shqyrtimit/leximit të projektpropozimeve.

Pikët maksimale për vlerësimin përfundimtar të OJF-ve janë 50 pikë.

Në aktin përfundimtar të vlerësimit do të renditen OJF-të me pikët më të larta në rend zbritës, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit.

Tabelë vlerësimi përmblledhëse e projektpropozimit

	Pikët maksimale	Pikët maksimale	Pikët maksimale	Pikëzimi mesatar
	Anëtar 1	Anëtar 2	Anëtar 3	
1. Kapaciteti i organizatës jofitimprurëse për projekte të ngjashme	10			
1.1 A ka organizata eksperiencë të mjaftueshme në menaxhimin e projekteve të ngjashme?				
1.2 A disponon organizata vërtetime nga partnerët për realizimin e suksesshëm të kontratave të grantit apo raporte vlerësuese pozitive të kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe financiare të OJF-së, të ushtruara nga shoqëri të licencuara auditimi?				
2. Kapaciteti profesional i burimeve njerëzore të organizatës	10			
2.1 A kanë punonjësit e organizatës përvojë në fushën e ndihmës juridike, si dhe a disponojnë certifikime të trajnimeve në funksion të objektivave të projektit?				
2.2 A kanë punonjësit e organizatës përvojë në fushën e financës, si dhe a disponojnë certifikime të trajnimeve në funksion të objektivave të projektit?				
2.3 A disponon organizata letra vlerësimi nga të paktën 2 (dy) subjekte përfutuese nga shërbimet e ndihmës juridike parësore?				
3. Ambiente të përshtatshme, të aksesueshme nga qytetarët	10			
3.1 A disponon organizata një vendndodhje lehtësisht të aksesueshme nga qytetarët? A ofrojnë mjediset ku do të ofrohet shërbimi mundësinë e aksesimit nga personat me aftësi të kufizuara?				
3.2 A disponon organizata pajisje të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të punonjësve (lista e inventarëve që OJF-ja administron)?				
3.3 A mundëson organizata një ambient të veçantë për trajnimin e rasteve të shërbimit të ndihmës juridike parësore me një karakter sensitiv?				
4. Performanca e organizatës që nga momenti i autorizimit për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga ministri i Drejtësisë	10			
4.1 Numri i rasteve të raportuara në baza mujore				
5. Buxheti dhe efikasiteti i kostos së projektpropozimit	10			
5.1 Sa është kostoja e zbatimit të projektit kundrejt targetit të parashikuar në projektpropozim nga organizata jofitimprurëse (numri i rasteve të shërbimit të ndihmës juridike)?				

Informacion sqarues mbi tabelën e vlerësimit:

Kapaciteti i organizatës jofitimprurëse për projekte të ngjashme (10 pikë)

Pyetja 1.1 (maksimumi i vlerësimit 5 pikë)

Në rast se vlera mesatare nga projektet e ngjashme të tre vjetëve të fundit të përcjella nga organizata është me e madhe ose e barabartë me dyfishin e shumës maksimale të financimit referuar thirrjes së DNJF-së, kjo pyetje vlerësohet me **5 pikë**.

Në rast se vlera mesatare nga projektet e ngjashme të tre viteve të fundit të përcjella nga organizata është nga vlera e shumës maksimale të financimit referuar thirrjes së DNJF-së, deri në dyfishin e shumës maksimale të financimit, kjo pyetje vlerësohet me **3 pikë**.

Në rast se vlera mesatare nga projektet e ngjashme të tre vjetëve të përcjella nga organizata është vogël se shumë maksimale e financimit referuar thirrjes së DNJF-së kjo pyetje vlerësohet me **1 pikë**.

Vlera mesatare nga projektet e ngjashme të tre vjetëve të fundit	Pikët e vlerësimit
>ose = 3 200 001 lekë	5 pikë
1 600 001 lekë – 3 200 000 lekë	3 pikë
< ose = 1 600 000 lekë	1 pikë

**Pyetja 1.2 (maksimumi i vlerësimit 5 pikë)**

Në rast se organizata disponon 1 vërtetim nga partnerët për realizimin e suksesshëm të kontratave të grantit, kjo pyetje vlerësohet me **3 pikë**.

Në rast se organizata disponon të paktën 1 raport vlerësues pozitiv të kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe financiare të OJF-së, të ushtruara nga shoqëri të licencuara auditimi kjo pyetje vlerësohet me **2 pikë**.

Nëse organizata disponon vërtetim nga partnerët, si dhe raport vlerësues pozitiv të kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe financiare, kjo pyetje vlerësohet me **5 pikë**.

Kapaciteti profesional i burimeve njerëzore të organizatës (10 pikë)**Pyetja 2.1 (maksimumi i vlerësimit 4 pikë)**

Në rast se punonjësit e organizatës kanë më shumë se 2 vjet përvojë në fushën e ndihmës juridike, si dhe janë të trajnuar në këtë fushë, atëherë kjo pyetje vlerësohet me **4 pikë**.

Në rast se punonjësit e organizatës kanë 1 deri në 2 vjet përvojë në fushën e ndihmës juridike, si dhe janë të trajnuar në këtë fushë, atëherë kjo pyetje vlerësohet me **2 pikë**.

Në rast se punonjësit e organizatës kanë deri në 1 vit përvojë në fushën e ndihmës juridike, si dhe janë të trajnuar në këtë fushë, atëherë kjo pyetje vlerësohet me **1 pikë**.

Pyetja 2.2 (maksimumi i vlerësimit 4 pikë)

Në rast se punonjësit e organizatës kanë më shumë se 2 vjet përvojë në fushën e financës, si dhe janë të trajnuar në këtë fushë, atëherë kjo pyetje vlerësohet me **4 pikë**.

Në rast se punonjësit e organizatës kanë 1 deri në 2 vjet përvojë në fushën e financës, si dhe janë të trajnuar në këtë fushë, atëherë kjo pyetje vlerësohet me **2 pikë**.

Në rast se punonjësit e organizatës kanë deri në 1 vit përvojë në fushën e financës, si dhe janë të trajnuar në këtë fushë, atëherë kjo pyetje vlerësohet me **1 pikë**.

Pyetja 2.3 (maksimumi i vlerësimit 2 pikë)

Në rast se organizata disponon letra vlerësimi nga 2 (dy) nga subjekte përfituese nga shërbimet e ndihmës juridike parësore, atëherë kjo pyetje

vlerësohet me **2 pikë**. Në rast se organizata disponon letra vlerësimi nga 1 subjekt përfitues nga shërbimet e ndihmës juridike parësore, atëherë kjo pyetje vlerësohet me **1 pikë**.

Ambiente të përshtatshme, të aksesueshme nga qytetarët (10 pikë)**Pyetja 3.1 (maksimumi i vlerësimit 5 pikë)**

Në rast se organizata është e vendosur në një vendndodhje lehtësisht të aksesueshme nga qytetarët (pranë institucioneve publike, si gjykatat, bashkitë, ADISA apo institucione të tjera publike), si dhe ofron lehtësirat për aksesimin nga personat me aftësi të kufizuara (rampë/ashensor etj.), kjo pyetje vlerësohet me **5 pikë**.

Në rast se organizata nuk është e vendosur në një vendndodhje lehtësisht të aksesueshme nga qytetarët (pranë institucioneve publike, si gjykatat, bashkitë, ADISA apo institucione të tjera publike), por ofron lehtësirat për aksesimin nga personat me aftësi të kufizuara (rampë/ashensor etj.), kjo pyetje vlerësohet me **2 pikë**.

Në rast se organizata nuk është e vendosur në një vendndodhje lehtësisht të aksesueshme nga qytetarët, si dhe nuk ofron lehtësirat për aksesimin nga personat me aftësi të kufizuara kjo pyetje vlerësohet me **0 pikë**.

Pyetja 3.2 (maksimumi i vlerësimit 3 pikë)

Në rast se organizata, referuar listës së inventarëve disponon mjete elektronike dhe pajisje zyresh në proporcion me numrin e punonjësve kjo pyetje vlerësohet me **3 pikë**.

Në rast se jo, kjo pyetje vlerësohet me **0 pikë**.

Pyetja nr. 3.3 (maksimumi i vlerësimit 2 pikë)

Në rast se organizata mundëson një ambient të veçuar për trajtimin e rasteve të shërbimit të ndihmës juridike parësore me një karakter sensitiv kjo pyetje vlerësohet me **2 pikë**.

Në rast se jo, kjo pyetje vlerësohet me **0 pikë**.

Performanca e organizatës që nga momenti i autorizimit për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga ministri i Drejtësisë (10 pikë).

**Pyetja nr. 4.1 (maksimumi i vlerësimit 10 pikë)**

Numri i rasteve të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore	Pikët e vlerësimit
Mbi 601 raste	10 pikë
501–600 raste	7 pikë
301–500 raste	5 pikë
Nën 300 raste	2 pikë

Pyetja nr. 5.1 (maksimumi i vlerësimit 10 pikë)

Kostoja për njësi (buxheti total në projektporpozim në raport me numrin e rasteve të përcaktuara në target)	Pikët e vlerësimit
Deri në 3,300	10 pikë
3,301–3,800	8 pikë
3,801–4,300	6 pikë
4,301–4,800	4 pikë
4,801–5,300	2 pikë

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Tiranë, 2022